



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:211122

Datë: 25.10.2023

Numri i dokumentit: 04828487

P.nr.739/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurës Xh.S., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.nr.7724/2017 e datës 15.02.2018, jashtë seancës gjyqësore duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datë 24.10.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I.HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.7724/2017, e datës 15.02.2018, e paraqitur ndaj të pandehurës Xh.S. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës dhe PUSHOHET procedura penale në këtë çështje penale, ngase ka kaluar koha e parashikuar me ligj për parashkrim absolut të ndjekjes penale.

II. E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 16.02.2018, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër, PP.II.nr.7724/2017 e datës 15.02.2018 kundër të pandehurës Xh.S., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

Gjyqtari i çështjes me këtë lëndë është ngarkuar me datë 11.10.2023, me ç'rast pas analizimit dhe shikimit të të gjitha provave dhe përkundër ndërmarrjes së gjitha veprimeve ligjore në mënyrë që të sigurohet prezenca e të pandehurit dhe që ndaj tij të zhvillohet procedura penale konsideron se vepra penale e cila i vihet në barrë të pandehurit të lartcekur, tanimë është përfshirë në parashkrim të ndjekjes penale sepse nga koha e kryerjes së veprës penale e deri më tani kanë kaluar më tepër se 6 vite, kohë kjo që shpie në parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Nga shkresat e lëndës shihet se e pandehura e, veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës sipas aktit akuzues së lartcekur, dyshohet se e ka kryer me datë 23.08.2017, ku për këtë lloje të veprës penale dënimi sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me numër 04/L-082, është e dënueshme me gjobë dhe dënim me burgim deri në 3 vjet.

Në nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së është përcaktuar se “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”, ndërsa në nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së, është parashikuar se ndjekja penale nuk mund të ndermirret nëse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), e në rastin konkret kanë kaluar më tepër se gjashtë (6) vite, kur dyshohet se është kryer vepra penale e lartcekur.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale dhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3, si dhe nenit 453 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

P.nr.739/18

Me datë 24.10.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.